



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice-Departamenti për  
Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.29/2023

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P. nr. 650/2021, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija - Kërveshi, pala ankuese nga , , përfaqësuesen e tij , avokate nga Prishtina, dhe përmbaruesi privat, me datë 15.12.2023, mori këtë:

## V E N D I M

Organi përmbarues - Përmbaruesi Privat , i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkalim i autorizimit të besuar me ligj, ashtu që të njëjtit i shqiptohet masa disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 3,000.00 euro (tre mijë), të cilën detyrohet të paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në llogarinë e Buxhetit të Odës së Përmbaruesve, nën kërcënimin e përmbarimit.

## A r s y e t i m

Pala ankuese me datë 26.10.2023, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat lëndor. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore lidhur me lëndën përmbarimore P. nr. 650/2021, ka kryer shkelje të dispozitave të LPP-së, duke i tejkualuar autorizimet e tij të përcaktuara me ligj. Kjo nga shkakun se përmbaruesi e ka ekzekutuar vendimin administrativ të Kuvendit komunal në , nr.15 nr.464-2935 dt,03.06.2013 dhe

vendimin nga i njëjti organ administrativ 15 nr.463-76605 dt.26.12.2018, edhe ndaj pronës së ankuesit edhe pse pala ankuese nuk ishte pjesë e vendimit të lartcekur. Për këto arsye ka kërkuar nga komisioni që ndaj përmbauesit privat të shqiptohet masa disiplinore.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, me datë 13.11.2023, ka paraqitur në Komision Disiplinor Raportin Përfundimtar, ndaj përmbauesit privat, si organ përmbaues, lidhur me veprimet e ndërmarra nga përmbauesi privat në lëndën përmbaimore P. nr 650/2021, me propozim që të ndërmerren veprimet e nevojshme lidhur me këtë rast.

Përmbauesi privat, në përgjigjen e tij me shkrim dhe seancën dëgjimore, e kundërshton në tërësi ankesën e palës ankuese si të pabazë, sepse asnjë veprim përmbarimor nuk është ndesh me LPP-ne, apo me ndonjë udhëzim administrativ. Për më tepër përmbauesi ka deklaruar se lejimi i përmbaimit të rasti P.nr.650-2021, është lejuar në bazë të vendimit administrativ të Kuvendit komunal në Lipjan, me nr.15 nr.464-2935 datë 03.06.2013 dhe vendimit nga i njëjti organ administrativ, 15 nr.463-76605 dt.26.12.2018, për plotësimin e vendimit të parë. Sipas përmbauesit privat Vendimet e lartcekura janë të Kuvendit Komunal, e të cilat janë bërë të plotfuqishme ku është ushtruar prapësimi ndaj urdhrit përmbarimor dhe Gjykata Themelore në [ ] e ka refuzuar prapësimin e palës ankuese me vendimin PPP nr.31-22 dt.25.07.2023. Më tutje përmbauesi privat ka theksuar se në këtë rast vetëm është zbauar vendimi i organit të lartcekur administrativ, për çka edhe i ka propozuar Komisionit Disiplinor që të refuzohet ankesa.

Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim se përmbauesi privat, ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni vlerëson së në këtë rast nuk është kontestuese se përmbauesi lëndor e ka lejuar përmbarimin në bazë të vendimit administrativ të Kuvendit Komunal të [ ]

Nuk është kontestuese poashtu se në Gjykatën Themelore në [ ] – Dega në [ ] është refuzuar prapësimi i debitorëve përfshirë edhe palën ankuese në këtë procedure dhe nuk është kontestuese se pala ankuese sipas certifikatës së pronës së datës 10.10.2023, është në pronësi individuale.

Kontestuese në këtë çështje mbetet se veprimi përmbarimor i përmbauesit privat me rastin e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ lëndor, a ka bërë shkelje disiplinore duke e



tejkaluar autorizimin e tij të besuar me ligj dhe a iu ka përmbajtur përmbaruesi privat ligjit me rastin e ekzekutimit të vendimit administrativ në rastin konkret.

Me nenin 367 paragrafi 1, nënparagrafet 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: “1.1 Nëse përmbaruesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj” dhe “1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit”.

Komisioni, vlerëson brenda juridiksionit të tij se përmbaruesi privat në këtë rast ka bërë shkelje disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimit përmbarimor të rasti P.nr.650/2021, në raport me palën ankuese, sepse pala ankuese nuk ka qenë pjesë e procedurës së vendimeve administrative të Kuvendit Komunal në me nr.15 nr.464-2935 i datës 03.06.2013 dhe Vendimit nga i njëjti organ administrativ , 15 nr.463-76605 i datës 26.12.2018, me të cilat iu ka mundësuar pronarëve për t'i këmbyer pronat e tyre e as nuk ka pasur kontratë të noterizuar tek noteri siç kërkohet me vendimin e lartcekur administrativ. Andaj komisioni gjen se përmbaruesi privat në këtë rast ka bërë shkelje disiplinore dhe ka rënë në kundërshtim me dispozitat e lartcituara ligjore ,ngase e ka lejuar përmbarimin në bazë të vendimit administrativ edhe ndaj palës ankuese në këtë rast, pa qenë fare palë në procedurë tek dokumenti mbi të cilin është lejuar përmbarimi. Për këto arsye komisioni gjen se përmbaruesi privat për gjatë kryerjes së veprimit përmbarimor të rasti P.nr.650/2021, në raport me palën ankuese e ka tejkaluar autorizimin e tij të besuar me ligj dhe nuk iu ka përmbajtur ligjit sepse ka ndërmarrë veprim përmbarimor edhe ndaj palës ankuese siç u konstatua edhe më lart pa qenë fare palë në procedurë.

Komisioni me rastin e vendosjes , mori për bazë edhe pretendimin e përmbaruesit privat, i cili theksoi se për këtë çështje ka vendosur sipas prapësimit me aktvendim PPP nr.31/22 të datë 25.07.2023, Gjykata Themelore në – Dega në dhe e ka refuzuar prapësimin e palës ankuese. Komisioni i rikujton përmbaruesit privat se kemi të bëjmë me procedura të ndara, pasi që procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vlerësimit të rigozitetit formal të dokumentit mbi të cilin është lejuar përmbarimi, që kjo çështje nuk është në juridiksionin e këtij komisioni dhe nuk është lëshuar në vlerësimin e kësaj procedure pasi që kjo është çështje që e vlerëson gjykata ashtu siç edhe e ka vlerësuar si më lart. Mirëpo në këtë rast juridiksionin i këtij komisioni është që ta vlerëson ndërmarrjen e veprimit përmbarimor nga përmbaruesit privat, se veprimi përmbarimor konkret, a është në harmoni me dispozitat e lart cituara ligjore, që në këtë rast siç u konstatua dhe u arsyetua më lart, ka rezultuar se veprimi përmbarimor lëndor i ndërmarrë nga përmbaruesi privat është në kundërshtim me dispozitën e lartcekur ligjore, prandaj pretendimi i përmbaruesit privat ka qenë pa ndikim në vendim marrje ndryshe në këtë rast.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor mori parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht faktin - peshën e dëmit të shkaktuar ndaj palës ankuese, e cila ka do të ndikonte në lartësinë e masës së shqiptuar. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me gjobë në të holla bazuar në nenin 368 paragrafi 1 nën paragrafi 3 i LPP-së, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat e rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve përmbarimore, të përmbaruesit privat si dhe tek përmbaruesit tjerë privat që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës. Ndërsa detyrimin se ku duhet të bëhet pagesa e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi, u bazua në nenin 11 të LIGJI NR. 08/L-102 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L-118, përcaktohet se: "*Neni 368 i ligjit bazik, paragrafi 3, togfjalëshi "në buxhetin e Republikës së Kosovës", ndryshohen me togfjalëshin "në buxhetin e Odës së Përmbaruesve"*", andaj gjoba e shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi duhet të paguhet në llogarinë e buxhetit të Odës së Përmbaruesve.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr 29/2023 datë 15.12.2023**

**Kryesuesja e Komisionit Disiplinor**  
**Manushe Karaçi**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.